



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 gusht 2024  
Nr.ref.: AGJ 2522/24

## AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI23/24

Parashtrues

**Agim Zogaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së  
Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë  
Kosovare të Privatizimit [AC-I-21-0836-A0001], të 26 tetorit 2023**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Agim Zogaj nga Malisheva (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Besnik K. Berisha, avokat në Komunën e Prishtinës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I-21-0836-A0001] të 26 tetorit 2023 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), në ndërlidhje me Aktgjykimin [C. IV-15-0687] e 15 nëntorit 2021 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-21-0836-A0001] të 26 tetorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe të rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 31 janar 2024, parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 shkurt 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI23/24] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues, ndërkaq përmes Vendimit [Nr. KSH. KI23/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 21 shkurt 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua DHPGJS-së.
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 20 maj 2024, parashtruesi i kërkesës përmes parashtrësës dorëzoi dokumente shitesë në Gjykatë, respektivisht katër (4) aktgjykime të DHPGJ-së përmes të cilave ishin aprovuar pjesërisht kërkesëpaditë e paditësve, ish-punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore "Auto Prishtina" (në tekstin e mëtejme: NSH "Auto Prishtina"), listën e 12 shtatorit 2014 me emrat e punëtorëve që nuk kishin marrë pagat, deklaratën e ish-drejtorit të NSH "Auto Prishtina" lidhur me nënshkrimin e kësaj liste, vendimin për fillimin e likuidimit të NSH "Auto Prishtina" dhe Marrëveshjen për shërbime në likuidim të lidhur ndërmjet Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Autoriteti i Likuidimit i AKP-së) dhe R.Z., të 1 janarit 2015.

11. Më 17 korrik 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë pas këshillimit, vendosi: (i) të deklarojë, njëzëri, kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë, njëzëri, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) të shpallë, njëzëri, të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-21-0836-A0001] e 26 tetorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së; dhe (iv) të kthejë, njëzëri, Aktgjykimin [AC-I-21-0836-A0001] e 26 tetorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në NSH “Auto Prishtina, ndërmarrje kjo e cila hyri në likuidim më 21 korrik 2014.
13. Më 11 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për kompensim për pagat e papaguara pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, për periudhën tetor 2003-qershor 2014, në shumën prej 19,370.00 euro (nëntëmbëdhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë euro).
14. Nga shkresat e rastit rezulton se më 12 shtator 2014, menaxhmenti i NSH “Auto Prishtina” kishte dorëzuar tek AKP-ja regjistrin e punëtorëve të cilëve nuk u ishin paguar pagat në tërësi.
15. Më 31 mars 2015, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së, përmes Vendimit [PRN-126-0177] e refuzoi kërkesën e lartcekur të parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se kërkesa ishte parashkuar.
16. Më 29 prill 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në DHPGJS, kundër AKP-së, dhe NSH “Auto Prishtina”, përmes së cilës kërkoi që t’i njëhej e drejta e kompensimit për pagat e papaguara për periudhën kohore të lartpërmendur, me kamatë prej 3.5% për çdo vit. Nëpërmjet padisë së tij, parashtruesi i kërkesës theksoi se nuk kishte rreshtur së kërkuari pagat e papaguara deri në njoftimin se kishte filluar procedura e likuidimit e NSH “Auto Prishtina”.
17. Më 3 tetor 2017, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së paraqiti parashtresë në mbrojtje ndaj padisë së parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës e kundërshtoi kërkesëpadinë si të parashkuar me arsyetimin se “... parashtruesi nuk ndërmori asnjë veprim ligjor kundër NSH-së në periudhën trevjeçare të parashkrimit e cila fillon të llogaritet më së voni nga shtatori i vitit 2003, kur parashtruesi ka pretenduar se nuk është paguar nga NSH-ja ...”. Për më tepër, në mbrojtjen ndaj padisë së parashtruesit të kërkesës, u kundërshtua pretendimi i parashtruesit të kërkesës se vazhdimisht kishte kërkuar kompensimin e pagave të papaguara, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur asnjë provë që dëshmonte këtë.
18. Më 16 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në mbrojtjen e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, duke theksuar se: “... për sa i përket parashkrimit të borxhit nuk ekziston sepse kërkesa e të punësuarit ka qenë permanente, ai ka marrë akonatacion nga punëdhënësi për çdo muaj nga 85,00 euro dhe kështu ka ndodhë deri në datën e fillimit të likuidimit më 21 korrik 2014...pala paditëse ka ushtruar padi pasi që kërkesa e punëtorëve e dorëzuar në AKP me datë 11.09.2014 dhe pasi nga dorëzimi i kërkesës së bashku me regjistër nga 38 të punësuar kanë kaluar më shumë se 30 ditë, të punësuarit kanë ushtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me datë 29.04.2015”.

19. Më 2 nëntor 2017, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së paraqiti kundërpërgjigje në përgjigjen e parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës ritheksoi pretendimet si në mbrojtje ndaj padisë dhe, ndër tjera, deklaroi se “... *Pretendimi se parashtruesi nuk ka mundur të dorëzojë një padi në gjykatat e Kosovës është gjithashtu i pabazuar. Ligji i DHPGJS-së që nga viti 2002 i ka lejuar parashtruesit dorëzimin e një padie kundër NSH-së. Mundësia për të kërkuar gjyqësisht ka qenë gjithmonë e hapur dhe vetëm me nisjen e procedurave të likuidimit në vitin 2014 ka ndryshuar destinacioni i padisë (nga DHPGJS tek Autoriteti i Likuidimit)...Nga viti 2003... Parashtruesi ka dështuar të dorëzojë një padi për të kërkuar rrogat e tij, rrjedhimisht të drejtat e tij u parashkruan...”.*
20. Më 15 nëntor 2021, DHPGJS, përmes Aktgjykimit [C-IV-15-0687]: (i) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ashtu që obligoi AKP-në që në procedurën e likuidimit të NSH “Auto Prishtina”, kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ta trajtojë si kërkesë të pranuar për shumën prej 19,370.00 euro, me kamatë në lartësi prej 10%; (ii) obligoi AKP-në, përkatësisht Autoritetin e Likuidimit, për përmbushjen e kërkesës konform nenit 40, par. 1 nënpar. 1.6.1 dhe nenit 41 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; dhe (iii) vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta.
21. Përmes Aktgjykimit [C-IV-15-0687], DHPGJS, theksoi si në vijim: “*Sipas shkresave të lëndës-provave në mbështetje të kërkesës rezultoi se parashtruesi i kërkesës në vazhdimësi kishte kërkuar kompensimin e të ardhurave personale-pagave sipas kontratës- dhe e paditura e ka konfirmuar ekzistimin e këtij detyrimi. Tani paditësi ka paraqitur kërkesë kreditore te tani e paditura, kërkesë kjo që i është refuzuar me Vendimin e AL-së PRN126-0177 i dt. 31.03.2015. Parashtruesi i kërkesës kreditore pavarësisht se nuk ka dorëzuar ankesë kundër vendimit të AL-së, në dt. 29.04.2015 me dorëzimin e padisë në këtë gjykatë, konsiderohet se paditësi ka shfrytëzuar mundësinë e inicimit të procedurës për mbrojtjen e të drejtave të tij brenda afatit ligjor konform nenit 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës”.*
22. Në lidhje me parashkrimin e borxhit, DHPGJS, duke iu referuar paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 368 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (GZ. numër 16, 19 qershor 2012) (në tekstin e mëtejme: LMD), për sa i përket ndërprerjes së parashkrimit përmes pranimit të borxhit në mënyrë të tërthortë, vlerësoi se AKP nuk e kishte kontestuar autoritetin dhe kompetencat e organeve drejtuese të NSH “Auto Prishtina” në parashtrësën nr. 8063 drejtuar kësaj të fundit më 16 korrik 2014. Më tej, në arsyetimin e aktgjykimit të saj, DHPGJS theksoi: “... *nuk është kontestuese se vet e paditura me Listën e punëtorëve aktivë të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës e evidentuar me nr.4 dt. 12.06.2014 e kishte pohuar ekzistimin e detyrimit në emër të pagës së papaguar për tani paditësin në shumën tani të kërkuar, dhe nuk është kontestuese se AKP ka respektuar në vazhdimësi autoritetin dhe kompetencat e organeve drejtuese të tani të paditurës deri në ditën e fillimit të procedurës së likuidimit, përkatësisht deri në ditën kur tani paditësi kishte dorëzuar kërkesën kreditore te tani e paditura”.*
23. DHPGJS, përmes Aktgjykimit [C-IV-15-0687], vendosi të mos caktojë seancë gjyqësore në këtë çështje duke u bazuar në nenin 398 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (GZ. numër 38, 20 shtator 2008) (në tekstin e mëtejme: LPK) dhe paragrafit 3 të nenit 76 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (GZ. numër 12, 27 qershor 2019) (në tekstin e mëtejme: Ligji për DHPGJS për Çështjet në lidhje me AKP-në), pasi që vlerësoi se nuk ishte kontestuese gjendja faktike. Në këtë drejtim, DHPGJS theksoi si në vijim:

*“Konform nenit 398 të LPK-së i zbatueshëm në bazë të nenit 76, par. 3 të Ligjit Nr.06/L-086: “Kur gjykata pasi t’i arrij përgjigjja në padi, dhe konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.*

*Prandaj, kjo gjykatë, pas përfundimit të procedurave me shkrim-deklarimit të palëve dhe shfrytëzimit të gjitha mundësive për prezantimin e provave si në mbështetje ashtu edhe në kundërshtim të kërkesëpadisë, kjo gjykatë vendosi që në bazë të nenit 398 të LPK-së vendimin meritore ta marrë pa mbajtur seancë, dhe e aprovoi kërkesën si të bazuar”.*

24. Më 21 dhjetor 2021, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së dorëzoi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, kundër aktgjykimit të lartpërmendur të DHPGJS-së, për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe juridike, me propozimin që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të vërtetohet Vendimi PRN126-0177 i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së i 31 marsit 2015. Në ankesë, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së theksoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ishin parashkruar pasi që ai nuk kishte ofruar prova për dorëzimin e kërkesës së tij para gjykatës apo ndonjë organi kompetent para se të përfundonte periudha e parashkrimit. Në lidhje me këtë, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së, iu referua disa aktgjykimeve ku gjykata kishte vlerësuar si të drejtë vendimet e Autoritetit të Likuidimit për sa i përket zbatimit të parashkrimit në afatin brenda tri (3) viteve.
25. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 27 mars 2023, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje në ankesë pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, me propozimin që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar i DHPGJS-së.
26. Më 26 tetor 2023, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit [AC-I-21-0836-A0001] vendosi: (i) Ankesa e të paditurës është e bazuar; (ii) Ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-15-0687 i 15 nëntorit 2021. (iii) Padia e paditësit refuzohet si e pabazuar; dhe (iv) nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.
27. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së në aktgjykimin e saj fillimisht vendosi që të mos mbajë pjesën gojore të procedurës bazuar në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit për DHPGJS-në për çështjet në lidhje me AKP-në.
28. Përmes Aktgjykimit [AC-I-21-0836-A0001], Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vlerësoi se DHPGJS nuk kishte vepruar drejtë kur kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Në këtë drejtim, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme vlerësoi si në vijim:

*“Kolegji i Apelit konsideron se aprovimi i kërkesëpadisë së paditësit nuk ishte veprim i drejtë nga ana e shkallës së parë të DHPGJS-së.*

*Ndërmarrja shoqërore “Auto Prishtina” kishte hyrë në likuidim më 21 korrik 2014. Që nga momenti i hyrjes në likuidim të kësaj ndërmarrjeje i gjithë autoriteti e kompetencat lidhur me këtë ndërmarrje i kanë kaluar Autoritetit të Likuidimit, që do të thotë se çdo vendim i marrë pas datës 21 korrik 2014 nuk është i vlefshëm.*

*Në këtë rast, lista e punëtorëve aktivë të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës e lëshuar nga N.SH. “Auto Prishtina” e datës 12 shtator 2014,*

të cilës shkalla e parë e DHPGJS-së i kishte falur besimin duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ishte përpiluar nga N.SH. pas hyrjes në likuidim të ndërmarrjes në fjalë (21 korrik 2014), që do të thotë se e njëjta në këtë situatë është e pavlefshme sepse të gjitha kompetencat i kishin kaluar Autoritetit të Likuidimit dhe N.SH nuk ka pasë asnjë autorizim të ndërmarr ndonjë veprim/vendim apo të pranojë borxh si në rastin konkret”.

29. Përmes Aktgjykimit [AC-I-21-0836-A0001], Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, mbështetur në paragrafin 1 të nenit 353 të LMD-së, konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën e pretenduar ishte parashkruar. Në këtë aspekt, në arsyetimin e aktgjykimit të lartcekur u theksua si në vijim:

*“Fillimisht, paditësi me asnjë provë nuk kishte arritur të dëshmojë se me ndonjë veprim të ndërmarrë nga AKP-ja i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Pastaj, i njëjti me asnjë provë nuk kishte dëshmuar se kishte paraqitur kërkesën e tij në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit dhe kështu të ndërprente afatin e parashkrimit.*

*Duke u bazuar në nenin 353, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) “Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.*

*Pra, nga dispozita e lartcekur shihet që kërkesa e paditësit për paga të papaguara në shumën dhe për periudhën e pretenduar është parashkruar dhe i njëjti nuk ka arritur me asnjë provë ta dëshmojë se e kishte ndërprerë parashkrimin”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
31. Parashtruesi i kërkesës thekson se i është shkelur e drejta e tij për t’u dëgjuar në lidhje me çështjen e tij pasi që DHPGJS dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk kanë mbajtur fare seancë dëgjimore. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Në rastin konkret me mosshqyrtim verbal dhe publik të çështjes, nuk është respektuar parimi i drejtpërdrejtshmërisë dhe kontradiktoritetit, në çështjen civilo-juridike kontestuese, ku është vendosur për kompensimin e pagave të mbetura borxh nga e paditura. Kjo gjë është shkaktuar si nga shkalla e parë ashtu edhe nga shkalla e dytë, e Gjykatës së rastit, sepse edhe shkalla e dytë, është lëshuar në çështje faktike (me vendosjen meritorie me rastin e refuzimit të ankesës me të cilën është atakuar edhe baza juridike ankimore, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike). Parashtruesi i kërkesës thekson se Kolegji i Apelit dhe shkalla e parë në këtë rast kanë vepruar sikur të vendosnin që të refuzonin për shkaqe procedurale, e në rastin konkret çështja ka qenë meritorie dhe çështja ka qenë mjaft komplekse me kontradita të shumta mes palëve ndërgjyqëse”.* Parashtruesi i kërkesës gjithashtu shton *“lidhur me precedente të tilla tashmë edhe Gjykata Kushtetuese ka vendosur për çka mund t’i referoheni rasteve KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI186/19, KI187/19, KI200/19 dhe KI208/19, me parashtrues Belkize Vula Shala dhe të tjerët, Aktgjykim i 28 prillit 2021) etj”.*

32. Më tej, përmes parashtresës së dorëzuar, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar shkel në tërësi dispozitat e ligjit material dhe procedural si dhe parimin e sigurisë juridike, pasi që sipas tij i njëjti është në kundërshtim me praktikën gjyqësore, pasi që në aktgjykimet shtesë të dorëzuara, për ish-punëtorët e NSH "Auto Prishtina", DHPGJS ka aprovuar pjesërisht kërkesëpaditë e tyre, duke u bazuar edhe në listën e 12 shtatorit 2014, ndërkaq që në rastin e tij Kolegji i Apelit i DHPGJS-së të njëjtën e kishte trajtuar si provë që nuk prodhon efekt juridik.

## **DISPOZITAT PËRKATËSE KUSHTETUESE DHE LIGJORE**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.  
[...]"*

### **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

#### **Neni 6**

#### **(E drejta për një proces të rregullt)**

*"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.  
[...]"*

### **LIGJI Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

#### **Neni 6**

#### **(Fushëveprimi i kompetencave administrative të Agjencisë)**

*"1. Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. Ky autoritet përfshinë çdo veprim që agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur, brenda kufijve të burimeve administrative të Agjencisë, për të mundësuar më mirë shitjen, likuidimin, transferimin apo ndonjë zgjidhje tjetër të ndërmarrjes, asetit apo interesit në pronësi shtetërore. Pa paragjykim*

*ndaj përgjithësimin në fjalinë e mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që sa i përket ndërmarrjeve, ai autoritet të përfshijë të gjitha veprimet të cilat Agjencia i konsideron të arsyeshme dhe të duhura për ruajtjen ose rritjen e vlerës, shanseve për sukses ose qeverisjes së ndërmarrjes”.*

## **SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

### **Neni 40 (Prioritetet e kërkesave dhe interesave)**

*“1. Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim:*

*[...]*

*1.7.kërkesat e pasiguruarra, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë;*

*[...]”*

## **LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

### **Neni 69 (Procedurat e ankesës me gojë)**

*“1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*

*[...]”*

### **Neni 76 (Konfliktet dhe interpretimi)**

*[...]”*

*3. Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”.*

## **LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE**

### **Neni 398 [Pa titull]**

*“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë...”.*

## **LIGJI Nr. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE**



**Neni 353**  
**[Kërkesat periodike]**

*“1. Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.  
[...]*”

**Neni 368**  
**[Pranimi i borxhit]**

*“1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.  
2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”.*

**LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS**

**Neni 78**  
**[Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit]**

*“1. Punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.  
2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.  
3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”.*

**Neni 79**  
**[Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë]**

*“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78, paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente”.*

**Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

33. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
34. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

35. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale) 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

36. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-21-0836-A0001] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 26 tetorit 2023, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
37. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

## **Meritat**

38. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, paraqitur tek Autoriteti i Likuidimit i AKP-së, për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën tetor 2003-qershor 2014, si i punësuar tek NSH “Auto Prishtina”. Më 31 mars 2015, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së, përmes Vendimit [PRN-126-0177] e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se kërkesa ishte parashkruar. Kësisoj, më 29 prill 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në DHPGJS, kundër AKP-së dhe NSH “Auto Prishtina”, përmes së cilës kërkoi që t'i njihej e drejta e kompensimit për pagat e papaguara për periudhën kohore të lartpërmendur. Autoriteti i Likuidimit i AKP-së dorëzoi parashtrësë në mbrojtje ndaj padisë së parashtruesit të

kërkesës të cilën e kundërshtoi si të parashkruar. Në lidhje me të, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në mbrojtjen e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, ku ky i fundit më pas paraqiti kundërpërgjigje. Më 15 nëntor 2021, DHPGJS, përmes Aktgjykimit [C-IV-15-0687] e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ashtu që obligoi AKP-në që në procedurën e likuidimit të NSH “Auto Prishtina”, kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ta trajtojë si kërkesë të pranuar, si dhe vendosi të mos mbajë seancë dëgjimore. Kundër aktgjykimit të DHPGJS-së, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së dorëzoi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe juridike, ndaj të cilës më pas, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në ankesë. Më 26 tetor 2023, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit [AC-I-21-0836-A0001] vlerësoi si të bazuar ankesën e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë, ashtu që refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se sipas dispozitave të LMD-së kërkesa e tij ishte parashkruar. Gjithashtu, përmes aktgjykimit të lartpërmendur, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vendosi të mos mbajë seancë të shqyrtimit gjyqësor.

39. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës me arsyetimin se përmes aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, kjo e fundit ka zbatuar gabimisht ligjin dhe ka vendosur në kundërshtim me praktikën gjyqësore të DHPGJS-së, konkretisht në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, pasi përmes aktgjykimeve të dorëzuara, për ish punëtorët e NSH “Auto Prishtina”, DHPGJS, kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpaditë e tyre, duke u bazuar edhe në listën e 12 shtatorit 2014, të cilën në rastin e tij, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e kishte trajtuar si provë që nuk prodhon efekt juridik. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës si rezultat i mungesës së seancës dëgjimore pranë DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në thelb, paraqet pretendim për mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor, veçanërisht në raport me mos-marrjen si provë të vlefshme të listës së 12 shtatorit 2014 nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së.
40. Bazuar në atë çka u tha më lart, duke marrë parasysh natyrën e kësaj kërkesë dhe pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata në vijim do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me (i) mosarsyetimin e vendimit gjyqësor; dhe (ii) mungesën e mbajtjes së seancës dëgjimore pranë DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

### **I. Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me shkeljen e të drejtës për një “vendim të arsyetuar”**

#### *a) Parimet e përgjithshme*

41. Garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
42. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjen për pranueshmërinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke dhënë arsyeime për të gjitha vendimet e saj (shih rastin e GJEDNJ-së, [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).

43. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së, [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).
44. Neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 0544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1990, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
45. Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtresave që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjyqimeve (shih rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
46. Megjithatë, nëse parashtresa e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).
47. Prandaj, gjykatat janë të obliguara që:
- (a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GJEDNJ-së [Buzescu kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 24 gushtit 2005, nr. 61302/00, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgjisë](#), nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35);
- (b) të shqyrtojnë me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollat e saj (shih rastet e GJEDNJ-së [Fabris kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 72; [Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut](#), nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
48. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon nga Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02, Vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë](#) (nr. 2), nr. 12686/03, Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
49. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, gjykata e apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, [Tatishvili kundër Rosisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo

kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.

50. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GJEDNJ-së [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
51. Përveç kësaj, GJEDNJ nuk përcaktoi se ishte shkelur e drejta në një rast në të cilin nuk është dhënë një sqarim specifik në lidhje me një pohim që i referohej një aspekti të parëndësishëm të rastit, përkatësisht mungesës së nënshkrimit dhe vulës, që është një gabim i një natyre më shumë formale sesa materiale dhe ai gabim u korrigjua menjëherë (shih rastin e GJEDNJ-së, [Mugoša kundër Malit të Zi](#), nr. 76522/12, Aktgjykim i 21 shtatorit 2016, paragrafi 63).

*b) Zbatimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

52. Sa i përket zbatimit të parimeve të lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës mbi arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata rikujton se në rastin konkret parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka shkelur dispozitat e ligjit material dhe procedural kur kishte aprovuar ankesën e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe refuzuar kërkesëpadinë e tij si të parashkruar.
53. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën tetor 2003-qershor 2014, duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 353 të LMD-së i cili përcakton si në vijim:

*“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.”*
54. Gjykata, më tej, thekson se sipas nenit 369 të LMD-së, *“parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.”* Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, më 11 shtator 2014, paraqiti kërkesë për kompensim për pagat e papaguara pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së ndërsa me 29 prill 2015 dorëzoi padinë kundër Autoritetit të Likuidimit të AKP-së në DHPGJS.
55. Bazuar në atë çka u cek më lart, Gjykata sjell në vëmendje faktin se parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar kompensimin e pagave të papaguara për një periudhë që përfshin 11 (njëmbëdhjetë) vite, kërkesë të cilën Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e refuzoi si të parashkruar. Megjithatë, Gjykata vëren se përmes aktgjykimit të lartcekur, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk ka shpjeguar se si parashkrimi ishte arritur edhe për 3 (tre) vitet e fundit para paraqitjes së padisë, gjegjësisht për vitet 2011-2014.
56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së është mjaftuar me vlerësimin se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ishte parashkruar në mungesë të ofrimit të ndonjë prove mbi ndërprerjen e parashkrimit dhe pavlefshmërisë së listës së 12 shtatorit 2014. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk ka ofruar arsyetim se si është arritur parashkrimi i kërkesëpadisë për 3 (tre) vitet e

fundit, por është mjaftuar me një konkludim të përgjithshëm se kërkesëpadia e tij në lidhje me kompensimin e pagave të papaguara për periudhën tetor 2003-qershor 2014.

57. Përkitazi me konstatimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së se parashtruesi i kërkesës nuk kishte arritur me asnjë provë të dëshmojë se kishte ndërprerë parashkrimin, Gjykata rikujton se në arsyetimin e aktgjykimit të DHPGJS-së si dhe në arsyetimin e aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, theksohet se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të kërkesëpadisë së tij, padisë i kishte bashkëngjitur, ndër tjera, këto prova: njoftimin për ushtrimin e padisë të dorëzuar në AKP me 23 prill 2015, kontratën e punës, letrën e AKP-së të 16 korrikut 2014 drejtuar menaxhmentit të NSH "Auto Prishtina dhe listën e punëtorëve aktivë të cilët nuk i kishin pranuar pagat. Në lidhje me këtë, Gjykata vlerëson se mbi parashtruesin e kërkesës është vënë barrë joproportionale në ofrimin e provave tjera meqenëse parashtruesi i kërkesës, bazuar në arsyetimet e aktgjykimeve të lartcekura, i ka dorëzuar provat që ka pasur në dispozicion, ndërkaq që provat e tjera mund të kenë qenë tek institucioni, përkatësisht tek AKP.
58. Tutje, Gjykata rikujton se, në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar në Gjykatë 4 (katër) aktgjykime të DHPGJS-së përmes së cilave janë aprovuar pjesërisht kërkesëpaditë e ish-punëtorëve të NSH "Auto Prishtina", respektivisht aktgjykimet në rastin e H.G., R.Z., S.B. dhe A.Z. Gjykata vëren se, në këto raste, DHPGJS, mbështetur në nenin 353 të LMD-së ka konstatuar se kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara që i takon 3 (tre) viteve të fundit, përkatësisht periudhës përkatëse 2011-2014 nuk është parashkruar. Gjithashtu, përmes aktgjykimeve në rastet e lartcekura, Gjykata vëren se DHPGJS ka pranuar si provë jonktestuese listën e 12 shtatorit 2014 me emrat e punëtorëve aktivë të cilët nuk kishin marrë pagat, të cilën Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e kishte konsideruar si të pavlefshme.
59. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me rast të ndryshimit të aktgjykimit të DHPGJS-së dhe, rrjedhimisht, refuzimit të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, nuk ka ofruar arsyetim se pse i është refuzuar kërkesëpadia si e parashkruar mbi bazën e paragrafit 1 të nenit 353 të LMD-së, për periudhën kohore që përfshin vitet 2011-2014.
60. Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, vendimi i një gjykate të apelit, megjithatë, duhet të përmbajë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykate më e ulët (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62; dhe shih rastin e Gjykatës, [KI36/22](#), parashtrues "Matkos Group" SH.P.K, Aktgjykim i 18 janarit 2023, cituar me lart, paragrafi 127).
61. Në dritën e vlerësimeve të lartcekura, Gjykata konstaton se Aktgjykimi [AC-I-21-0836-A0001] i 26 tetorit 2023 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, nuk plotëson kriteret e një "gjykimi të drejtë" sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor.
- (i) *Lidhur me pretendimin për mungesë të seancës dëgjimore*
62. Në vlerësimin pretendimin të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës si rezultat i mungesës së seancës dëgjimore, Gjykata do t'i referohet (i) parimeve të përgjithshme të vendosura nga GJEDNJ lidhur me të drejtën për seancë dëgjimore sipas nenit 6 të KEDNJ-së, dhe më pas të njëjtat (ii) do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.
- (i) *Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së*

63. Gjykata fillimisht thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka vendosur parimet themelore përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, Gjykata, gjithashtu ka përcaktuar parimet dhe përjashtimet përkatëse, bazuar në të cilat vlerësohet domosdoshmëria e mbajtjes së një seance dëgjimore, varësisht nga rrethanat e rasteve përkatëse (shih, rastet e Gjykatës [KI145/19](#), [KI146/19](#), [KI147/19](#), [KI149/19](#), [KI150/19](#), [KI151/19](#), [KI152/19](#), [KI153/19](#), [KI154/19](#), [KI155/19](#), [KI156/19](#), [KI157/19](#) dhe [KI159/19](#), parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafët 47-54 dhe [KI160/19](#), [KI161/19](#), [KI162/19](#), [KI164/19](#), [KI165/19](#), [KI166/19](#), [KI167/19](#), [KI168/19](#), [KI169/19](#), [KI170/19](#), [KI171/19](#), [KI172/19](#), [KI173/19](#) dhe [KI178/19](#), parashtrues *Muhamet Këndusi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 27 janarit 2021, paragrafët 46-53).
64. Karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore mbron palët ndërgjyqëse nga administrimi i drejtësisë në fshehtësi, në mungesë të një shqyrtimi publik. Për më shumë, publiciteti i procedurave gjyqësore është një nga mekanizmat kryesorë përmes të cilës ruhet besimi në drejtësi. Një parim i tillë, për më tepër, kontribuon në arritjen e qëllimeve të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike të mishëruara në KEDNJ (shih, rastin e GJEDNJ-së [Malhous kundër Republikës Çeke](#), nr. 33071/96, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 55).
65. Në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. Për aq sa është relevante për rrethanat e tanishme, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim.
66. Për sa i përket detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë, GJEDNJ ka theksuar se në procedurat para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një seancë dëgjimore është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, rastet e GJEDNJ-së [Fredin kundër Suedisë \(nr. 2\)](#), nr. 18928/91, Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; [Allan Jacobsson kundër Suedisë \(nr. 2\)](#), nr. 16970/90, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46; dhe [Salomonsson kundër Suedisë](#), nr. 38978/97, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Përjashtime nga këto raste, në parim, bëhen vetëm nëse “ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore”, (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë](#), nr. 32303/13, Aktgjykim i 13 qershorit 2018, paragrafi 36), dhe të cilat GJEDNJ, përmes praktikës së saj gjyqësore i ka përcaktuar si raste që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike (shih, rastin e GJEDNJ-së [Kootummel kundër Austrisë](#), nr. 49616/06, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafët 19-20).
67. Lidhur me detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Salomonsson kundër Suedisë](#), cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore (shih, rastet e GJEDNJ-së [Miller kundër Suedisë](#), nr. 55853/00, Aktgjykim i

- 8 shkurtit 2005, paragrafi 30; dhe [Helmerts kundër Suedisë](#), nr. 11826/85, Aktgjykim i 29 tetorit 1991, paragrafi 36).
68. Për sa i përket parimeve në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, në rastin [Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë](#), përmes së cilit u vendosën parimet në bazë të cilave duhet të vlerësohet domosdoshmëria e mbajtjes së një seance dëgjimore (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë](#), Aktgjykim i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13 57728/13 74041/13, paragrafët 190-191).
69. Sipas këtij aktgjykimi, një seancë dëgjimore nuk është e domosdoshme që të mbahet, nëse rasti përkatës (i) nuk ngërthen çështje të besueshmërisë ose fakteve të kontestuar që kërkojnë mbajtjen e një seance dëgjimore dhe kur gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme rastin në bazë të shkresave të lëndës (shih, rastet e GJEDNJ-së [Döry kundër Suedisë](#), nr. 28394/95, Aktgjykim i 12 shkurtit 2003, paragrafi 37); [Saccoccia kundër Austrisë](#), nr. 69917/01, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73; dhe [Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë](#), cituar më lart, paragrafi 36; (ii) ngërthen thjeshtë çështje juridike të një natyre të kufizuar (shih, rastet e GJEDNJ-së [Allan Jacobsson kundër Suedisë \(nr. 2\)](#), cituar më lart, paragrafi 49; dhe [Valová, Slezák dhe Slezák kundër Sllovakisë](#), Aktgjykim i 1 shtatorit 2004, paragrafët 65-68) ose nuk ngërthen ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë (shih rastin e GJEDNJ-së, [Varela Assalino kundër Portugalisë](#), nr. 64336/01, Vendim i 25 prillit 2002); dhe (iii) ngërthen çështje tepër teknike, të cilat trajtohen më mirë me shkrim sesa përmes argumenteve gojore në një seancë dëgjimore (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Döry kundër Suedisë](#), cituar më lart, paragrafi 41).
70. Në të kundërtën, sipas vlerësimit të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së në rastin [Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë](#), mbajtja e seancës dëgjimore është e nevojshme atëherë kur: (i) shqyrtohen çështje të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat vlerësohet nëse autoritetet i kanë vertetuar saktë faktet (shih, rastin e GJEDNJ-së [Malhous kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafi 60); (ii) kur rrethanat kërkojnë që gjykata të krijojë përshtypjen e saj për palët ndërgjyqëse duke u dhënë atyre të drejtën të shpjegojnë situatën e tyre personale, në emër të tyre ose nëpërmjet përfaqësuesit (shih, rastin e GJEDNJ-së [Miller kundër Suedisë](#), cituar më lart, paragrafi 34); dhe (iii) kur gjykata duhet të marrë sqarime në disa pika përmes mbajtjes së seancës dëgjimore (shih, rastin e GJEDNJ-së [Lundevall kundër Suedisë](#), nr. 38629/97, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 39).
71. Përkitazi me mundësinë e korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë dhe kritereve respektive, GJEDNJ, përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se në parim, një korrigjim i tillë varet nga kompetencat e gjykatës më të lartë. Nëse kjo e fundit, ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar meritat e rastit përkatës, përfshirë edhe vlerësimin e fakteve, atëherë korrigjimi i mungesës së një seance dëgjimore në shkallë të parë, mund të bëhet në shkallën e dytë (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë](#), cituar më lart, paragrafi 192).
72. Lidhur me heqjen dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore publike, GJEDNJ ka theksuar se as shkronja dhe as fryma e nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së nuk e pengojnë një individ që të heqë dorë vullnetarisht nga e drejta e tij për një seancë dëgjimore publike, shprehimisht ose në heshtje, por një heqje dorë duhet të jetë e qartë dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me çdo interes të rëndësishëm publik (shih, rastet e GJEDNJ-së [Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës](#), cituar më lart, paragrafi 59; [Håkansson dhe Sturesson kundër Suedisë](#), nr. 11855/85, Aktgjykimi 21



shkurtit 1990, paragrafi 66; [Exel kundër Republikës Çeke](#), nr. 48962/99, Aktgjykim i 5 tetorit 2005, paragrafi 46. Ftesa për seancë duhet të merret gjithashtu me kohë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Yakovlev kundër Rusisë](#), nr. 72701/01, Aktgjykim i 15 marsit 2005, paragrafët 20–22).

73. Po ashtu, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fakti që palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore nuk do të thotë që kanë hequr dorë nga e drejta për të mbajtur një të tillë. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një çështje e tillë varet nga karakteristikat e ligjit vendor dhe rrethanat e secilit rast veç e veç (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Göç kundër Turqisë](#), nr. 36590/97, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 48 dhe [Exel kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafi 47 ).

(ii) *Zbatimi i parimeve të shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret*

74. Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, në parim, garanton mbajtjen e një seance dëgjimore në të paktën njërin nivel të vendimmarrjes. Një e tillë është, në parim (i) e detyrueshme nëse gjykata e shkallës së parë ka kompetencën e vetme të vendimmarrjes përkritazi me çështjet e faktit dhe të ligjit; (ii) jo e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallë të parë, përkundër faktit që një përcaktim i tillë varet nga karakteristikat e rastit përkatës, për shembull, nëse shkalla e dytë vendos edhe për çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një e tillë nuk është mbajtur në shkallë të parë, në rastet kur shkalla e dytë ka kompetencë të plotë për të vlerësuar vendimin e shkallës së parë, edhe përkritazi me çështjet e faktit dhe të ligjit.
75. Përjashtime nga rastet e mësipërme, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të bëhen vetëm nëse “*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*”, siç janë rastet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike (shih, rastet e GJEDNJ-së [Mirovni Institut kundër Sllovenisë](#), cituar më lart, paragrafi 36; dhe [Koottummel kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafët 19-20); dhe atëherë kur gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme rastin në bazë të shkresave të lëndës (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë](#), cituar më lart, paragrafët 190-191; [Varela Assalino kundër Portugalisë](#), cituar më lart; dhe [Döry kundër Suedisë](#), cituar më lart, paragrafi 37).
76. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës fillimisht kishte dorëzuar kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit i AKP-së për kompensimin e pagave të papaguara, për periudhën tetor 2003-qershor 2014, si i punësuar tek NSH “Auto Prishtina”, kërkesë e cila ishte refuzuar me arsyetimin se ishte parashkruar. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës kishte filluar procedurën gjyqësore me padi pranë DHPGJS-së, kundër AKP-së dhe NSH “Auto Prishtina”, padi e cila ishte aprovuar si e bazuar nga DHPGJS. Kundër aktgjykimit të DHPGJS-së, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së paraqiti ankesë pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, ankesë të cilën kjo e fundit përmes aktgjykimit e vlerësoi të bazuar dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë me arsyetimin se sipas dispozitave të LMD-së kërkesa e tij ishte parashkruar.
77. Më tej, Gjykata vëren se gjatë procedurës së zhvilluar pranë DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, nuk është mbajtur seancë dëgjimore, gjë që sipas parashtruesit të kërkesës shkel të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.
78. Gjykata tutje thekson se nga shkresat e lëndës nuk rezulton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore para DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

79. Për sa i përket mosmbajtjes së seancës gjyqësore, Gjykata rikujton se DHPGJS nuk caktoi seancë dëgjimore me arsyetimin se në mes palëve nuk ishte kontestuese gjendja faktike ndërkaq që Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes aktgjykimit me të cilin ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë, vendosi që të mos mbajë pjesën gojore të procedurës bazuar në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit për DHPGJS-në për çështjet në lidhje me AKP-në.
80. Gjykata rikujton se bazuar në nenin 69 (Procedurat e ankesës me gojë) të Ligjit për DHPGJS-në për çështjet në lidhje me AKP-në, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse, në bazë të nismës së tij apo edhe kërkesës me shkrim nga një palë. Rrjedhimisht, mbajtja e një seance dëgjimore në nivel apeli, jodetyrimisht varet nga kërkesa e palës. Është gjithashtu detyrë e Kolegjit përkatës, që bazuar në nismën e tij, të vlerësojë nëse rrethanat e një rasti kërkojnë mbajtjen e një seance dëgjimore. Për më tepër, bazuar në nenin 66 (Përmbajtja e ankesës) dhe nenin 70 (Paraqitja e provave të reja) të Ligjit për DHPGJS-në për çështjet në lidhje me AKP-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të vlerësojë edhe çështjet e ligjit edhe të faktit, dhe për pasojë, është e pajisur me kompetencë të plotë për të vlerësuar mënyrën se si ka vlerësuar faktet shkalla e parë e DHPGJS-së. Në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e DHPGJS-së në dëm të parashtruesit të kërkesës. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh dispozitat ligjore, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e një seance dëgjimore në Kolegj të Apelit është e justifikuar vetëm si rezultat i mungesës së një kërkesë nga palët në procedurë, posaçërisht marrë parasysh faktin që parashtruesi i kërkesës nuk është ankuar kundër aktgjykimit të DHPGJS-së, i cili ishte në favor të tij.
81. Tutje, siç është cekur më lart, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, jodetyrimisht do të thotë se ka hequr dorë nga një kërkesë e tillë dhe gjithashtu mungesa e kësaj kërkesë jodetyrimisht e liron gjykatën përkatëse nga detyrimi për mbajtjen e një seance të tillë (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Göç kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 48 dhe rastin e Gjykatës [KI145/19](#), [KI146/19](#), [KI147/19](#), [KI149/19](#), [KI150/19](#), [KI151/19](#), [KI152/19](#), [KI153/19](#), [KI154/19](#), [KI155/19](#), [KI156/19](#), [KI157/19](#) dhe [KI159/19](#), parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 54).
82. Gjykata, në vijim, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore në të dy shkallët e vendimmarrjes, përkatësisht nëse natyra e çështjeve në vlerësim para DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, mund të klasifikohet si “*ekskluzivisht ligjore apo e natyrës së lartë teknike*”.

*Nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat justifikojnë mungesën e seancës dëgjimore*

83. Gjykata edhe një herë rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë. Përjashtimi nga e drejta për një seancë dëgjimore ekziston vetëm ato raste në të cilat përcaktohet se “*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*” dhe që sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së janë klasifikuar si raste të cilat ndërliken me “*çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike*”.
84. Shembuj të çështjeve të natyrës së lartë teknike në të cilat jodetyrimisht është e domosdoshme një seancë dëgjimore, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ekzistojnë tek çështjet që ndërliken me sigurime sociale (shih, rastin e GJEDNJ-së

- Döry kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafi 41). Në mënyrë të ngjashme, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të cilën e ka ndjekur Gjykata, mungesa e seancës dëgjimore nuk rezulton në shkelje në ato raste në të cilat çështjet para gjykatës përkatëse janë ekskluzivisht ligjore (shih, rastet e GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 73 dhe *Allan Jacobsson kundër Suedisë (no. 2)*, cituar më lart, paragrafi 49; dhe *KI80/23*, parashtrues *Behgjet Stoliqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2024, paragrafi 47; dhe *KI125/23*, parashtrues *Hazir Publica*, Aktvendim për papranueshmëri i 31 janarit 2024, paragrafi 46).
85. Në të kundërtën, në rastet në të cilat çështjet para gjykatave përkatëse ngërthenin edhe çështje fakti edhe ligji, GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore, të përvetësuar nga Gjykata, nuk konstatoi se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore (shih, rastet e GJEDNJ-së *Malhous kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 60 dhe *Koottummel kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafët 20-21 si dhe rastin e Gjykatës *KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19*, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 72).
86. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht rikujton që Kolegji i Apelit, ka juridiksion që të trajtojë si çështjet e faktit ashtu edhe çështjet e ligjit. Bazuar në paragrafin 11 të nenit 9 (Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet) të Ligjit për DHPGJS-në për Çështjet në lidhje me AKP-në dhe paragrafin 4 të nenit 69 (Procedurat e ankesës me gojë) dhe nenin 70 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, palët, ndër tjerash, kanë mundësinë që të ngritin ankesat para Kolegjit të Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit edhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqesin prova të reja.
87. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata rikujton se përmes Aktgjykimit në rastin *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, GJEDNJ, specifikisht kishte përcaktuar se një seancë dëgjimore është e domosdoshme në rrethana që ngërthejnë nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë. Kjo vlen posaçërisht në rrethana në të cilat, një seancë dëgjimore nuk është mbajtur as para shkallës më të ulët, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret.
88. Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata vëren se DHPGJS përmes aktgjykimit aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën nga tetori 2003 deri më 21 korrik 2014, me arsyetimin se (i) parashtruesi i kërkesës vazhdimisht kishte kërkuar pagesën e pagave të papaguara dhe se (ii) përmes listës së punëtorëve aktivë, e paditura kishte pohuar ekzistimin e borxhit të papaguar. Pas ankesës së parashtruar nga AKP me pretendimin se DHPGJS kishte vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe gabimisht kishte zbatuar të drejtën materiale, aktgjykimi i shkallës së parë u ndryshua nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, me arsyetimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte parashkruar sipas paragrafit 1 të nenit 353 të LMD-së.
89. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se konstatimin e lartcekur për parashkrimin e kërkesëpadisë, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e bazoi në (i) mungesën e ofrimit të provave nga ana e parashtruesit të kërkesës për dorëzimin e kërkesës së tij në gjykatë apo tek ndonjë autoritet tjetër kompetent, brenda tre (3) viteve nga momenti kur N.SH “Auto Prishtina” pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj; dhe (ii) pavlefshmërisë së listës së punëtorëve të lëshuar nga N.SH. “Auto Prishtina”, me arsyetimin se nga hyrja e kësaj të fundit në likuidim me 21 korrik 2014, i gjithë autoriteti e kompetencat i

kishin kaluar Autoritetit të Likuidimit të AKP-së. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, si në vijim:

*Në këtë rast lista e punëtorëve aktivë të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës e lëshuar nga N.SH. "Auto Prishtina" e datës 12 shtator 2014, të cilës shkalla e parë e DHPGJS-së i kishte falur besimin duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ishte përpiluar nga N.SH. pas hyrjes në likuidim të ndërmarrjes në fjalë (21 korrik 2014), që do të thotë se e njëjta në këtë situatë është e pavlefshme sepse të gjitha kompetencat i kishin kaluar Autoritetit të Likuidimit dhe N.SH nuk ka pasë asnjë autorizim të ndërmerre ndonjë veprim/ vendim apo të pranojë borxh si në rastin konkret."*

90. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit kishte ndryshuar aktgjykimin e DHPGJS-së përmes vlerësimit si të pavlefshme të listës së punëtorëve të lëshuar nga NSH "Auto Prishtina, në të cilën ishte bazuar edhe DHPGJS kur kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se përmes kësaj liste e paditura kishte pohuar ekzistimin në emër të pagës së papaguar. Gjithashtu, Kolegji i Apelit e kishte arsyetuar vendimin e vet bazuar në mungesën e ofrimit të provave nga parashtruesi i kërkesës për ndërprejren e marrëdhënies së punës me ndonjë veprim të ndërmarrë nga AKP dhe se nuk kishte dëshmuar ndërprejren e parashkrimit, përmes paraqitjes në kohë të kërkesës së tij për kompensim.
91. Gjykata vëren se në arsyetimin e aktgjykimit të DHPGJS-së si dhe në arsyetimin e aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së theksohet se parashtruesi i kërkesës, në mbështetje të kërkesëpadisë së tij, padisë i kishte bashkëngjitur, ndër tjera, këto prova: njoftimin për ushtrimin e padisë të dorëzuar në AKP me 23 prill 2015, kontratën e punës, letrën e AKP-së të 16 korrikut 2014 drejtuar menaxhmentit të NSH "Auto Prishtina dhe listën e punëtorëve aktivë të 12 shtatorit 2014 të cilët nuk i kishin pranuar pagat.
92. Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së mbajtja e një seance dëgjimore konsiderohet e nevojshme kurduhet të shqyrtohen çështjet e ligjit dhe çështjet e rëndësishme faktike (shih, rastin e GJEDNJ-së [Fischer kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 44) ose kur është e nevojshme të vlerësohet nëse autoritetet i kanë vërtetuar saktë faktet (shih, rastin e GJEDNJ-së [Malhous kundër Republikës Çeke \[DHM\]](#), cituar më lart, paragrafi 60) dhe kur është e nevojshme të sigurohet që faktet përkatëse të shqyrtohen më në detaje (shih, rastin e GJEDNJ-së [Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë \[DHM\]](#), cituar më lart, paragrafi 211).
93. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se nuk është kontestuese hyrja në likuidim e NSH "Auto Prishtina". Megjithatë, Gjykata thekson se mbajtja e një seance dëgjimore në rastin e parashtruesit të kërkesës, nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, ka qenë e nevojshme në mënyrë që të sqarohen paqartësitë lidhur me vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e listës së punëtorëve të lëshuar nga NSH "Auto Prishtina", përfundimin e marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës dhe mungesën e provave të ofruara nga ai.
94. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se çështja në shqyrtim para DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nuk ngërthen (i) çështje ekskluzivisht ligjore apo (ii) çështje të natyrës teknike. Përkundrazi, çështja në shqyrtim para DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së ngërthente çështje të rëndësishme faktike dhe ligjore. Si rezultat, Gjykata vlerëson se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e justifikojnë mungesën e seancës dëgjimore dhe si rrjedhojë parashtruesit të kërkesës i është shkëlur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

95. Si përfundim, Gjykata konstaton se përmes aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, si rezultat i (i) interpretimit qartazi të gabuar të ligjit dhe (ii) mosmbajtjes së seancës dëgjimore, parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.


### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 17 korrik 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-21-0836-A0001] e 26 tetorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
- IV. TË KTHEJË Aktgjykimin [AC-I-21-0836-A0001] e 26 tetorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 60 (5) të Rregullores së punës, deri më 3 shkurt 2025, për masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

  
Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani